# DËSHMI ARKIVI

**A-479331**

Factcheck.al · arkiv i pandryshueshëm i mediave shqiptare

VERSIONI 3

**Ky dokument nuk është prova.** Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

## ARTIKULLI

| | |
|---|---|
| TITULLI | Kumbaro sqaron përdorimin e Inteligjencës Artificiale në shkolla: Nuk është me detyrim! Udhëzuesi tregon si të përdoret pa i bërë nxënësit dembelë - Shqiptarja.com |
| ADRESA | `https://shqiptarja.com/lajm/kumbaro-sqaron-pwrdorimin-e-inteligjences-artificiale-ne-shkolla-nuk-eshte-me-detyrim-udhezuesi-tregon-si-te-perdoret-pa-i-bere-nxenesit-dembele` |
| BURIMI | shqiptarja.com |
| GJENDJA | edited |

## KOHA

| | |
|---|---|
| KAPUR NGA NE | 29 shtator 2026, 13:25:27 UTC<br>*Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.* |
| DEKLARUAR NGA PORTALI | 29 shtator 2026, 13:21:56 UTC<br>*Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.* |

## HASH-ET · SHA-256

| | |
|---|---|
| PËRMBAJTJA | `9094cf669596dba787111e488e395b37571ec59b9b8b38414884e46f2bc603a0` |
| TEKSTI | `d33b98b3ce044a856378c2ac002ad39ead97be5fd7b69e4700fc15fae2b25d5d` |
| PAMJA | `9ae490e93e8a3213ff434f982ad46c88a776c8d75594afbfd89f2a6026b9369a` |

## ZINXHIRI I PROVËS

| | |
|---|---|
| KJO HYRJE | `1536320dbe6506c5bf4bd2b36a9b77006c5ef78ec85c26cc30ba94c7a0d81ae6` |
| E MËPARSHMJA | `ada9206e277ffa61ca3fa2de2c54a2a91474602437be2c08fd771071d67ee88d` |
| RRËNJA MERKLE | – |
| ANKORIMI | nuk është ankoruar ende<br>*Kjo hyrje nuk është përfshirë ende në asnjë pemë Merkle të dërguar. Zinxhiri i hash-eve provon rendin dhe integritetin; koha jo.* |

### SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahaso hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

`https://scan.stamles.eu/verify/1536320dbe6506c5bf4bd2b36a9b77006c5ef78ec85c26cc30ba94c7a0d81ae6`

## PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px



POP 5 Lajmet më të lexuara të 5 minutave të fundit
1



FOTO/ Trafik i çmendur në aksin Durrës-Tiranë, radhë kilometrike mjetesh në hyrje të kryeqytetit...dhe një polic që bllokon fluksin nga autostrada!

Sociale

# Kumbaro sqaron përdorimin e Inteligjencës Artificiale në shkolla: Nuk është me detyrim! Udhëzuesi tregon si të përdoret pa i bërë nxënësit dembelë

*Ministrja e Arsimit, Mirela Kumbaro, thotë se nuk ka asnjë vendim që detyron përdorimin e Inteligjencës Artificiale në shkolla. Sipas saj, është përgatitur vetëm një udhëzues për përdorimin etik të saj, me synimin që IA të ndihmojë mësuesit dhe nxënësit të zhvillojnë mendimin kritik.*



*Foto ilustruese*

[Sh].com Redaksia
29 Shtator, 15:15 | **Përditesimi: 29 Shtator, 15:25**

f Share Tweet




Inteligjenca Artificiale nuk do të jetë e detyrueshme në shkolla por ajo duhet përdorur në mënyrë etike. Gjatë një vizite në Elbasan, Ministrja e Arsimit, Mirela Kumbaro, ka sqaruar debatin për përdorimin e IA-së në procesin mësimor, duke theksuar se nuk ekziston asnjë vendim apo udhëzim që e bën atë të detyrueshme për nxënësit apo mësuesit.

> *"Nuk ka asnjë vendim apo udhëzim, dhe dua ta theksoj këtë, që të jetë futur inteligjenca artificiale me detyrim në shkollë. Nuk është e vërtetë, nuk ekziston" tha Kumbaro.*

Sipas Kumbaros, është përgatitur, së bashku me Agjencinë e Sigurimit të Cilësisë, një udhëzues që tregon se si Inteligjenca Artificiale mund të përdoret në mënyrë etike.

[Sh].com



LEXO EDHE:
**Rama propozon krijimin e Këshillit Kombëtar për fëmijët me aftësi ndryshe: Fuqizim i sistemit të mësuesve ndihmës dhe mbështetje ekstra financiare (VIDEO)**

> *"Ne kemi përgatitur, bashkë me Agjencinë e Sigurimit të Cilësisë, përgjegjëse për kurrikulat, udhëzuesin se si duhet përdorur inteligjenca artificiale në atë që quhet përdorimi etik. Përdorimi i inteligjencës artificiale jo si detyrim, por si mund ta përdorim që të zhvillojmë mendimin kritik", tha Kumbaro.*

Qasja që përshkruan Kumbaro lidhet edhe me atë që kryeministri Edi Rama tha pak ditë më parë në fjalimin e tij në Asamblenë e Përgjithshme të OKB-së për mënyrën se si duhet përdorur Inteligjenca

Artificiale.

Rama foli për një IA që duhet të ndihmojë në zhvillimin e aftësive njerëzore dhe jo t'i zëvendësojë ato.

> *"Ne mund të ndërtojmë një inteligjencë artificiale që mëson, në vend që thjesht të përgjigjet, që orienton, në vend që thjesht të komandojë e që fuqizon qenien njerëzore në vend që qenia njerëzore të bëhet e varur prej saj", tha Rama.*

Edhe Kumbaro e vendosi theksin te i njëjti shqetësim për shkollat: përdorimi i IA-së nuk duhet t'i shtyjë nxënësit drejt rrugës më të shkurtër, por t'i ndihmojë të zhvillojnë mendimin kritik.

> *"Përdorimi i inteligjencës artificiale duhet të përdoret për të nxitur mendimin kritik, nën udhëheqjen e mësuesve dhe jo të rrisë dembelizmin tek nxënësit", nënvizoi Kumbaro.*

U.D/Shqiptarja.com

TAG: edi rama | Mirela Kumbaro | inteligjenca artificiale

**Sa e vlerësoni këtë artikull?** ★★★★★ ★★★★☆ 4.0 / 5 (1 vlerësim)

LAJMET MË TË VLERËSUARA

**Komente**

Komento

© Ndalohet rreptësisht ripublikimi i këtij shkrimi, sipas nenit 80, ligji 35/2016

**Sondazhi i ditës:** 26 Shtator, 18:15

**Ambasadori i ri i SHBA nis misionin, a besoni se do sjellë ndryshim në mjedisin politik?**

Po | Jo | Disi

## Lajme të tjera



**PD 146 pyetje Begajt dhe Ramës pas arrestit të Hysenit: Çfarë kriteresh dhe verifikimesh u ndoqën për emërimin e saj në krye të SHISH? (PYETJET)**

29 Shtator, 14:27



**Rama sot në Bruksel për Samitin e Turizmit, sjell në vëmendje Shqipërinë si destinacion turistik**

29 Shtator, 08:36



**Shqipëria në 'sytë' e vizitorëve: Male të mrekullueshme! Arkitekturë ndryshe nga çdo vend! Veçojnë Muzeun Kombëtar, Bunk' Art dhe bregdetin (VIDEO)**

29 Shtator, 08:27



**Papa Leone XIV: Evropa të ruhet nga iluzioni i riarmatimit, guxim në negociata dhe të sakrifikojë për paqen! Duhet të garantojmë që IA të mos e shkatërrojë njerëzimin**



Gian Guido Vecchi

29 Shtator, 08:03



**'Dorëheqja' e Ramës/ Nata e Çunit të Fahriut si ministër i Brendshëm dhe pakti me Mulin**



Adriatik Doci

28 Shtator, 19:16



**Arresti i ish-kreut të SHISH/ PD kërkon dorëheqjen e Ramës, Spaho: Opozita di të bëjë vetëm zhurmë në Kuvend! Mazhoranca nuk është lëkundur**

28 Shtator, 18:23














Ylli Pata: Precedenti i rotacionit 'automatik' mori fund në 2009-n

Ylli Pata

28 Shtator, 17:58

FOTOLAJM/ U komandua në krye të SHISH pas shkarkimit të Hysenit, Elvis Lila për herë të parë në publik! Merr pjesë në Këshillin e Sigurisë

28 Shtator, 16:47

Asambleja e OKB në New York Kedhi: Aleatët i kthyen shpinën Ramës, regjimi i tij është i braktisur brenda dhe jashtë vendit

28 Shtator, 15:41









Trump kundër frenimit të inteligjencës artificiale, darkon me shefin e kompanisë Anthropic: Jemi 1 vit e gjysmë para Kinës, pse duhet të heqim dorë?

28 Shtator, 13:37

'Kam takim me gjermanin, më duhet të iki', Rama 'ndërpret' fjalimin e Schieder, eurodeputeti ia kthen me batutë: Mos ua përmend Greqinë sot se humbën (VIDEO)

28 Shtator, 12:37

Këshilli i Sigurimit u mblodh pas arrestit ndaj Hysenit/ Bardhi: Begaj manekin, aty kishte përfaqësues të Agasit! Rama të dorëhiqet

Danjela Maloku

28 Shtator, 12:24



© 2011 - 2026 Shqiptarja.com - Ndalohet riprodhimi i paautorizuar i kesaj faqeje

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.